


Busulla.COM është platforma zyrtare e MASH për orientim profesional, edukim dhe këshillim në karrierë.

Çka është të mësuarit e bazuar në projekte?

Të mësuarit e bazuar në projekte është aktivitet apo metodë mësimore përmes të cilës mëson duke identifikuar *"një problem të botës reale"* dhe duke i gjetur zgjidhje atij problemi. Me anë të të mësuarit të bazuar në projekte, nxënësit fitojnë njohuri dhe shkathtësi të ndryshme, të cilat pastaj ndihmojnë në zhvillimin e tyre akademik dhe profesional. Ky lloj i të mësuarit është më ndryshe se të mësuarit tradicional, për shkak se të mësuarit këtu bëhet përmes angazhimit aktiv dhe aktiviteteve të cilat kërkojnë bashkëpunim dhe janë shumë më argëtuese. Është e këshillueshme që të mësuarit e bazuar në projekte të bëhet në bashkëpunim me ndonjë mësues, ashtu që menaxhimi i projektit të jetë më i lehtë dhe është e rëndësishme të bëjmë edhe dallimin në mes të të mësuarit të bazuar në projekte dhe projekteve klasike.

Projekte klasike u referohemi atyre projekteve, temat e të cilave të janë të caktuara nga mësuesi dhe nxënësit bëjnë një prezantim rreth asaj teme me anë të një poster-prezantimi apo prezantimi në PowerPoint. Përderisa këto lloj projektsh janë më të shkurtra dhe më pak sfiduese, të mësuarit e bazuar në projekte janë më të gjata dhe qëllimin kryesor e kanë zhvillimin e njohurive, kreativitetit dhe shkathtësive të buta e forta që pastaj do të mund të përdoren tërë jetën.




Cilat janë qëllimet e aktivitetit?

Qëllimet e këtij aktiviteti janë nga më të ndryshmet. Ky aktivitet mundohet të zhvillojë njohuri të thella të përmbajtjeve që diskutohen gjatë realizimit të projektit, shkathtësi të punës në grup, komunikim, mendim kritik, kreativitet, menaxhim të kohës, zgjidhje të problemeve, shkathtësi hulumtuese, shkathtësi prezantuese, rritje të përgjegjesisë qytetare dhe veprimit personal, etj.



Si ta realizojmë aktivitetin?

Hulumtimi i një çështje, zbatimi dhe përfundimi i projektit zgjat nga disa ditë deri në disa javë. Projekti përfundimtar apo prezantimi i tij mund të bëhet në disa forma, si p.sh. prezantim me media të tilla si video, audio, grafikë, animacione, etj. Të mësuarit e bazuar në projekte zakonisht përbëhet nga **gjashtë hapa**, të shpjeguar në vijim.



Hapi 1

Zgjedhni dhe kuptoni problemin

Mbajeni një takim, bëni pyetje të hapura rreth problemeve apo sfidave që shkolla apo komuniteti ku jetoni është duke u përballur dhe shihen si të rëndësishme dhe zgjidhshme. Për ta pasur më të qartë të gjithë procesin e të mësuarit në bazë të projekteve, ne do të marrim një shembull

konkret që ta keni më të lehtë të kuptoni se si t'i qaseni.

Të themi se pas një hulumtimi dhe diskutimi se çka është diçka që mund të intervenohet, u identifikua se kushtet e dobëta ekonomike të një apo më shumë familjeve në rrethinën e qytetit/fshatit ku jetoni janë si problem që konsideroni që mund të kontribuoni në zgjidhjen e tij.

Hapi 2

Hulumtoni

Në hapin e dytë, ju duhet të merrni më shumë informata rreth çështjes dhe definoni cila është çështja që do ta adresoni, përshkruani në kontekst dhe ndërlidheni me eksperiencën në jetë reale.

Në rastin tonë konkret është gjendje jo e mirë financiare disa prej familjeve në rrethinën ku jetoni. Këto raste tashmë janë mjaft të shpeshta, sidomos me krizat financiar që pandemia COVID-19 ka sjellë. Këtu mund të hulumtoni dhe identifikoni se cilat familje kanë nevojë për përkrahje dhe të specifikoni çfarë përkrahje ju duhen, për shembull: ushqim, dru, barna, rroba, etj.

Hapi 3

Planifikoni

Bëni një plan veprimi se si do t'i qaseni çështjes dhe ndani përgjegjësitë në mes grupeve ose vullnetarëve. Në bashkëpunim me mësimdhënësin dhe grupet tuaja tashmë të ndara mund të ndani obligimet dhe përgjegjësitë që i keni për të realizuar projektin me sukses. Hapi i parë që duhet të bëni është të identifikoni mënyra se si mund të grumbulloni të ardhura. Një mënyrë për ta bërë këtë është që të planifikoni një ditë dhe të gatvani ushqime ne shtëpi, pastaj në

pushim të gjatë, nxënësit e tjerë të blejnë ushqimet e përgatitura dhe kështu të sigurohen fonde për blerjen e gjësendeve të nevojshme për familjet e zgjedhura paraprakisht. Identifikimi i aktivitetit që siguron të ardhura është vetëm fillimi. Planifikim duhet të bëhet edhe për ditën që do të mbahet aktiviteti, kush do të gatuj çka, kush do të merret me përgatitjen e vendit ku bëhet shitja e ushqimeve, kush do kryej pagesat, kush do të t'i njoftojë të tjerët për organizimin e shumë të tjera që dalin gjatë planifikimit të aktivitetit.

Hapi 4

Zbatoni

Në qoftë se hapi paraprak është realizuar mirë atëherë ky hap do të jetë shumë më i lehtë. Kur keni një plan konkret se si do të zbatoni projektin, krejt çka ju duhet është të përcillni hapat që i keni planifikuar paraprakisht dhe gjithçka do të shkoj mirë. Për shembull nëse grupi për menaxhim ka marrë përsipër planifikimin e kohës se kur do të bëhet shtija e produkteve dhe sigurimin e sallës atëherë ata duhet të fillojnë me realizimin e këtyre përgjegjësive. Pastaj të themi se grupi për organizim ka marrë përsipër të bëj sigurimin e mjeteve të nevojshme, të tilla si bankat ku do të

vendosen ushqimet, arkën për paratë, caktimin se cili nxënës do të përgatisë çka, atëherë fillojnë ta bëjnë atë. E njëjta logjikë vazhdohet edhe me grupin për informim, të cilët mund të sigurohen që nxënësit e tjerë të informohen për aktivitetin që do të zhvillohet dhe po ashtu të ftojnë edhe vullnetarë të tjerë që janë të interesuar të përgatisin ushqime për të grumbulluar sa më shumë fonde. Kurse në ditën e aktivitetit të gjithë së bashku të bashkëpunojnë për të pasur një aktivitet sa më të suksesshëm dhe për të arritur objektivat e vendosura gjatë planifikimit të projektit në përgjithësi. Në fund, bëhet numërimi i të hollave dhe blihen produktet e nevojshme e që pastaj dërgohen te familjet në nevojë.

Hapi 5

Vlerësoni dhe reflektoni

Pas realizimit të projektit është kohë të vlerësoni gjithë punën që keni bërë, çka ka shkuar mirë, çka ka mundur të shkonte më mirë, çfarë mund të bëni në të ardhmen për të bërë diçka edhe më të madhe, etj. Të

mësuarit bazuar në projekte, qëllim kryesor ka të mësuarit dhe marrjen e njohurive të reja, prandaj **reflektimi** është shumë i rëndësishëm sepse përmes tij ju do të mund të shikoni se çka keni mësuar prej kësaj përvoje, çfarë shkathtësi keni mësuar apo përmirësuar, si do të ju ndihmojnë njohuritë dhe shkathtësitë e marra në të ardhmen tuaj, etj.

Hapi 6

Prezantoni punën

Hapi i fundit është që duke bashkëpunuar dhe përdorur kreativitetin e njëri-tjetrit të përmbledhni projektin e bërë në një prezantim për të gjitha palët e përfshira në projekt dhe Klubet tjera. Prezantimi mund të

përmbaj informata si: si erdhët deri tek ideja, pse menduat që ai problem/sfidë ishte e rëndësishme për t'u adresuar, si e bëtë ndarjen e përgjegjësive, a shkoi gjithçka sipas planit, cila fazë ishte më e vështira për ju, cilat ishin arritjet kryesore të projektit tuaj dhe informata tjera që ju mendoni që janë të rëndësishme për t'u ndarë me të tjerët.

Ide për realizimin e të mësuarit të bazuar në projekte

Ju mund të zhvilloni aktivitetin e të mësuarit të bazuar në projekte përmes:

- Mbjelljes së bimëve në oborrin e shkollës (bimë dekorative ose pemë / perime).
- Përgatitja e një ekspozite (fotografi ose piktura) apo pikturimi i ndonjë murali për një temë të caktuar, p.sh. të drejtat e njeriut, e drejta për arsimim, pandemia, etj.
- Përgatitja e një historiku për shkollën që mund të postohet në faqen e shkollës në Facebook, ueb faqe, faqe të komunës apo sipas mundësisë të printohet dhe të vendoset në shkollë.
- Pastrimi i ambientit të shkollës dhe rrethinës së saj.

Si shembulli i prezantuar gjatë prezantimit të hapave por edhe shembujt e listuar më lartë janë vetëm sa për të ju njoftuar me konceptin e të mësuarit bazuar në projekte dhe si mund të realizohet. Prandaj, nuk është e domosdoshme të kufizoheni vetëm në këto ide. Madje jeni të inkurajuar që duke përdorur shkathhtësitë e mendimit kritik, hulumtimit dhe kreativitetin tuaj të gjeni ndonjë ide tjetër, të cilën do të mund të zhvilloni në kuadër të mësuarit në projekte, ku ju dhe shkolla juaj apo komuniteti do të përfitonin në mënyra të ndryshme.

Porta drejt karrierës tënde!



KCDF ruan të drejtën të përdorë të gjitha fotografitë që ky material i përmban.

© Fondacioni Kosovar për Zhvillim të Karrierës, Prishtinë, Janar 2021

© **GIZ** Ky material është zhvilluar me mbështetjen e Qeverisë Gjermane përmes Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH. Përmbajtja e tekstit origjinal është përgjegjësi e autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyron opinionin zyrtar të Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.